

PËRMBLEDHJA JOTEKNIKE E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Projekti: Përpunimi i mbetjeve të naftës nëpërmjet
metodës së Orimulsionit**

Me vendndodhje Sheq i Madh, Fier

Subjekti zhvillues: PETROSONIC ALBANIA sh.a

Permbajtja e raportit

1. Hyrje	2
1.1 Kërkesat ligjore.....	2
2. Përshkrimi i Projektit.....	3
3. Vleresimi i ndikimeve ne mjedis	12
3.1 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit.....	12
3.2 Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit.....	12
3.3 Ndikimet në ajër	13
3.4 Ndikimet në ujrat sipërfaqësore	13
3.5 Zhurmat.....	14
3.6 Krijimi i mbetjeve.....	14
3.7 Ndikimet pozitive të projektit	14
4. Masat për shmangien apo reduktimin e ndikimit në fazë ndërtimi dhe funksionimi .	14



1. Hyrje

Subjekti "PETROSONIC ALBANIA" me NIPT L01726011S synon zhvillimin e projektit për "Përpunimi i mbetjeve të naftës nëpërmjet metodës së Orimulsionit", projekt për të cilin kompania është pajisur me Deklaratë Mjedisore më datë 04.05.2016. Mbështetur në kërkesat e legjislacionit shqiptar kompania është duke ndjekur procedurat për tu pajisur me leje mjedisi.

Qëllimi i projektit për përpunimin e mbetjeve të naftës nëpërmjet metodës së Orimulsionimit ose teknologjia e deasfaltimit dhe ndarjes së bitumit nga nafta e rëndë e papërpunuar, naftës ose rërës. Përpunimi i rërës së papërpunuar nëpërmjet teknologjisë moderne si dhe shërbimet për palët e treta në sektorin e naftës dhe gazit. Zhvillimi i projektit do të sjellë mjaft përfitime në përmirësimin e gjendjes mjedisore në ato zona ku është zhvilluar industria e naftës si dhe përfitime ekonomike e sociale.




Figure 1: Vëndndodhja e projektit

1.1 Kërkesat ligjore

Bauar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", kreu II, neni 7, "Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen procedures se vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut

II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

Klasifikimi i raportit të VNM-së bazohet në shtojcat I dhe II të veprimtarive të përcaktuara në shtojcat e ligjit të VNM-së.

Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) *projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur ligjit të VNM-së*

Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:

- a) *projektet e listuara në shtojcën I;*

Projekti është pajisur me Deklaratë Mjedisore mbështetur në Shtojcën I, kod 9. Komapnia është në zbatim të kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.10448 date 14.7.2011, i ndryshuar, shtojca I, ID ID 5.4/a dhe procedurat e përcaktuar në vendimit nr. 419 datë 25.6.2014, kreu II.

Klasifikimi i mbetjeve që do të trajtohen

Mbetjet të cilat do të trajtohen nga ky impiant klasifikohen si **mbetje të rrezikshme** kjo bazuar në vendimin nr.99 të katalogut Shqipëtarë të klasifikimit të mbetjeve kod:

16 07 08* Mbetje që kanë naftë

2. Përshkrimi i Projektit


VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE PËRSHKRIMI I ZONËS

Impjanti është planifikuar të pozicionohet në zonën periferike hyrëse të qytetit të Fierit, saktësisht në veri-lindje të tij, në jug të lumit Seman. Lidhja e sheshit të impjantit me rrugën nacionale Tiranë-Fier kryhet nëpërmjet një rruge prej 1 kilometër e cila aktualisht shërben si rrugë aksesi për një sërë strukturash me karakter industrial, kryesisht të industrisë së njerrjes dhe prodhimit të materialeve të ndërtimit. Sheshi i impjantit të orimulsjonit përfshihet në zonën Planit të Integruar Sektorial për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vëndburimin Patos-Marinzë.



Perdorimi ekzistues i tokës në reze 1.5 km

Aktivitetet kryesore që rrethojnë zonën e sheshit të impjantit të orimulsjonit kanë funksione kryesisht industriale të industrisë së nxjerrejs dhe përpunimit të materialeve të ndërtimit si dhe të zonës industriale dhe tregëtare. Vetë zona e impjantit të orimulsjonit ndodhet brenda zonës së zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve të Planit të Integruar Sektorial miratuar me vendim të KKT nr. 28, datë 10.05.2013. Në këto kushte kjo zonë aktualisht rezulton mjaft e përshatshme për zhvillimin e një impjanti orimulsjoni, pasi është në përputhje të plotë me planet territoriale në fuqi si dhe funksionet industriale që zhvillohen në këtë zonë.



Sipërfaqja e objektit është 3000 m2.

Kapaciteti përpunues është 50 ton/ditë.


Impjanit është planifikuar të pozicionohet në zonën periferike hyrëse të qytetit të fierit saktësisht në veri-lindje të tij, në jug të lumit Seman. Lidhja e sheshit të impjantit me rrugën nacionale Tirane – Fier kryhet nëpërmjet një rruge prej 1 km e cila aktualisht shërben si rrugë aksesi për një sere strukturash me karakter industrial, kryesisht të industrisë së nxjerrjes dhe prodhimit të materialeve të ndërtimit. Sheshi I impjantit të orimulsionit përfshihet në zonën e Planit të Integruar Sektorial për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos Marinzë Miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) nr. 28 date 10.05.2013.

Cfarë është orimulsioni dhe si gjeneron vlerë.

Orimulsioni është:

- a) Teknologji e lëndës djegëse para-atomizuese për aplikim djegie/transporti në kaldaja, motorrë, turbina dhe gazsjellës.
- b) Orimulsioni është një përzierje që përbëhet prej:
70% = Hidrokarbon (masë bruto ose shumë e rëndë) pika me përmasë 2-5 mikron
30% = Ujë që rrethon pikat e stabilizuara të hidrokarbonit.
- c) Përdoruesit sot djegin një përzierje mes naftës së kushtueshme dhe miksit të solarit në vend që të djegin solarin në formën e orimulsionit I cili ka një kosto shumë më të ulët.

- d) SFO konverton mbetjet e rafinerisë në lëndë djegëse ekonomike pa shpërdoruar naftën
 e) Orimulsioni gjeneron vlerë domethënëse për rafineritë:
 Rritje volume për linjën e bardhë me vlerë të lartë dhe volume të reduktuara për linjën e zezë me vlerë të ulët.



* Linja e bardhë = Benzinë, Naftë, Jet fuel, Vajgur, etj.

Ndodhitë para dhe pas orimulsionit

Oportunitetet që vijnë nga teknologjia e orimulsionit

- 1- Aktualisht Shqipëria nuk disponon Gaz Natyral. Gazjellesit TAP do ti duhet kohe e gjate te perfundoje punimet. LPG eshte teper i kushtueshem per perdorim industrial. Nderkohe qe orimulsioni mund ta ule koston e lendes djegese per industrine, duke qene me i lire se Solari.
- 2- Industria e enegjise :mund te konvettohet te funksionoje me perdorimin e orimulsionit deri ne perfundimin e Projektit TAP.
- 3- Mbetjet e Rafinerise Armo mund te konvertohen ne orimulsion qe do te kushtoje dhe me pak se sa vete Solari qe prodhon Rafineria sot. Ketu fitojne si rafmeria ashtu dhe industria.
- 4-Orimulsioni eshte me pak i demshem per mjedisin se sa solari. Nivel me i ulet i NOX-it. djegie me e mire(Orimulsioni=100% ndersa Solari=85%)
- 5-Kursimet qe burojne nga ulja e koston jane perfitime per klientin dhe per rafinuesin.
- 6-Kursimet e naftes celin Oportunitete te tjera.

Karakteristikat e orimulsionit

- 1- Performance e jashtëzakonshme djegëse në krahasim me lëndet e lengshme
- 2- Viskozitet i ulët
- 3- Temperaturë e ulët, siguri me të lartë
- 4- Depozitim dhe përdorim normal lengu
- 5- Karakteristika djegëse si Metani
- 6- Kontakt i shkëlqyer nga Hidrokarboni në Oksigjen
- 7- Djegie 99.99+ % e karbonit.
- 8- Djegie me të shkurter
- 9- Gjeneratë NOx e ulët


Përdorimi Industrial i Orimulsionit

Në vendet ku Gaz i Natyror nuk është i disponueshëm:

Gjeneron Avull për prodhim energjie

Gjeneron energji të shpërndarë në motore ose turbina.

Zëvendëson gazin ngrohës të mëdhenj me ndezje direkte



Teknologjia e trajtimit, skicat dhe planimetritë e objekteve strukturave të projektit.

Përpunimi i mbetjeve të naftës dhe përdorimi perseri i tyre nuk është një çështje e lehtë. Kjo arrihet duke kaluar në një proces të cili përbëhet nga shumë hapa, si:

- Klasifikimi i mbetjeve
- Ndarja e naftës nga mbetjet e huaja.
- Përfitim i produkteve (naft, bitum dhe lëndë djegëse)

Ngarkimi i mbetjeve të naftës.

Mbetjet e naftës do të meren në vende të ndryshme nga subjektet e licencuara.

Ngarkimi dhe transporti i tyre do të kryhet me automjete të posaçëshme autobote, depozita me ngrohje dhe pompa thithëse.

Ngarkimi dhe transporti i tyre do të kryhet në përputhje me të gjitha kushtet e transportit të mbetjeve të rrezikshme.





Figura 1: Skema teknologjike e orimulsionit

Makinerite dhe pajisjet


- Pajisjet per transport dhe instalim
- Pajisjet per ndarje
- Makina dhe pajisje per dehidratim
- Makina dhe pajisje per perpunimin e produktit
- Depot dhe magazinat
- Stacioni per ngarkim

Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike


Projekti ne vetvete permбан instalim dhe ndertim te objektit. Pjesa me e rendesishme dhe me delikate eshte instalimi i impiantit. Puna per zbatimin e ketij projekti do te nise me pergatitjen e sheshit per instalimin e impiantit. Punimet e sheshit konsistojne ne rrethimin e truallit me mure, shtrimi me beton ose asfalt, pergatitja e hapësirave ku do te instalohet impianti dhe aksesore te tjere te tij. Gjate kesaj kohe do te jene perfunduar te gjitha procedurat me CEZ shperndarje per te kryer lidhjen e energjise elektrike. Ndertimi i ambienteve te sherbimit (zyra, dhoma e ndihmes se shpejte etj) do te kryhet nga punime te thjeshta me mure dhe beton. Instalimin e impiantit do ta quajme proces teknologjik pasi instalimi i tij do te kryhet nga automjete te posateshme, si dhe punimet do te ndiqen nga persona te specializuar. Pasi te jete perfunduar faza e instalimit te impiantit do te zbatohen punimet perfundimtare per instalimin e te gjithe infrastruktures.




Montimi i rezervuarve Konike te impjantit.



Skema e impjantit të prodhimit të bitumit.



Skema e sistemit të shuarjes së zjarrit të impiantit të bitumit.



Montimi I dhomave të shkumës në rezervuar.

Infrastruktura e nevojshme

Lidhja me rrjetin elektrik

Furnizimi me energji elektrike do te kryhet nga rrjeti publik i shperndarjes sipas kontrates me CEZ per nevojat e objektit industrial. Furnizimi me energji do te jete ajror dhe ne piken ku do te behet lidhja e pajisjeve brenda truallit do te jene instalime tokesore,

Furnizimin me uje

Per plotesimin e nevojave per uji kompania ka planifikuar hapjen e pusit brenda zones se projektit Uji si lende e domosdoshme ne procesin teknologjik do te sigurohet nga riperdorimi I ujit i cili perftohet nga procesi i trajtimit

Shkarkimet e ujerave te ndotura

Ujrat teknologji pasi te kene kaluar ne separator do te pushojne ne dekantues nga aty ato do te ngarkohen me autobote per tu shkarkuar ne pikat e shkarkimeve publike, kjo do te ndodhe vetem ne ato raste kur cilesia e ujit eshte brenda normave te lejuara te cilesise. Ujrat e zeza do te shkarkohen ne grope septike.

Programi per ndertimin, kohezgjatjen, lendet e para te ndertimit qe do te perdoren

Permiresimi i rruges hyrese dhe pergatitja e sheshit te impjantit do te shoqerohet me ndikime te natyrave te ndryshme ne zonen e projektit gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te impjantit.

Ndikimet do te jene te karakterit te meposhtem:

1. Shtim i trafikut
2. Bllokim i mundshem i rruges ne zone
3. Ndikim ne stabilitetin e terrenit.
4. Pluhur nga qarkullimi i automjeteve

Gjate fazes se shfrytezimit ndikimet do te jene te karakterit:

1. Ndikim ne trafik
2. Kontrolli i shpejtesise se levizjes
2. Pluhur nga qarkullimi i automjeteve

Per t'ju dhene nje pergjigje shqetesimeve te mesiperme, eshte menduar qe gjate zgjedhjes se alternatives me te pershtatshme per rrugen hyrese per ne sheshin e impjantit dhe nepermjet projektit te ndertimit te rruges dhe sheshit. Keto do te shoqerohen me masa organizative dhe shperndarjen ne kohe te punimeve per ti bere sa me efikase masat e marra.

Afatet

Koha e ndertimit. Ndertimi i impjantit te orimulsjonit do te zgjase rreth 30 dite. Pas ndertimit, Petrosonic Energy Ltd, do te vazhdoje punen per venien ne eficence te plote te impjantit.

Mirembajtja

a. Rregullimi i trafikut. Rregullimi i trafikut do të jete minimal për sheshin dhe rrugën e zgjedhur. Mund të kërkohej rregullim i trafikut kur të linde nevojë për qarkullimin e ngarkesave të mëdha, por kjo nuk do të jete me bazë ditore.

b. Rruga hyrëse nga rruga kryesore: të gjitha rrugët hyrëse do të përmiresohen për të lehtësuar trafikun dhe ndonjë demtim të mundshëm prej ngarkesave të mëdha do të riparohet në kohën e duhur.

Ndertimi i rruges. Punimet për rrugën do të marrin në konsideratë specifikën e përdorimit të kësaj rruge, ngarkesat dhe dendësinë e qarkullimit në të. Në bazë të peshave që do të transportohen në rrugën dytesore kësaj peshe do të behen gjithë llogaritjet dhe punimet për rrugën.

Pergatitja e sheshit të impjantit Sheshi i impjantit do të ndërtohet sipas projektit. Do të përfshijë nivelimin e sheshit, shtresën prej guresh me trashësi 60 cm dhe në fund nivelimin me një shtresë prej 10 cm çakelli të imet.

3. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis

3.1 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit

Në karakteristikat fizike përfshihen ndryshime në topografinë e sipërfaqes ku do të zbatohet projekti, mundësi për të pasur erozion apo rrëshqitje si dhe tjetërsim i tipareve të përgjithshme të peisazhit.

Si rezultat i relievit ekzistues si dhe nga punimet që do të kryhen nuk vlerësohet të ketë asnjë gjasë për të pasur erozion apo rrëshqitje.

Në truallin ku do të zbatohet ky projekt nuk ka asnjë objekt ekzistues si dhe në këtë truall nuk gjenden pemë frutore apo dekorative kështu që zbatimi i projektit nuk do të sjellë ndryshime të rëndësishme në peisazh. Në peisazhin e përgjithshëm ekzistues vlerësohet të ketë tjetërsim të peisazhit ekzistues nga tokë arë në tokë e shfrytëzuar për aktivite industriale.

3.2 Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit

Në truallin e projektit gjenden bimë me natyrë barishtore dhe më pak shkurre. Përberja faunistike përfshin lloje të gjitarëve, zvarranik dhe shpendë të cilat gjenden përgjatë gjithë këtij rajoni.

Biodiversiteti

Nga kryerja e punimeve për ndërtimin e impiantit do të largohet shtresa vegetative ekzituese ky ndikim vlerësohet të jetë i pa rëndësishëm, pasi siç e kemi theksuar në këtë sipërfaqe nuk gjenden lloje të veçanta fauistike.

Habitat

Ndikimet në habitat do të kenë kryesisht karakter besdisës jo dëmtues. Besdisja e tyre do të shkaktohet nga këto burime:

- *Nga prania e zhurmave si rezultat e punës së automjeteve*
- *Nga qarkullimi i automjeteve të punës me shpejtësi të pakontrolluar apo pa ndriçim të mjaftueshëm.*

Projekti vlerësohet të jetë mjaft pozitiv në reduktimin e betjeve të patrajuara që janë shkakruar në trupat ujorë të zonës duke ndikuar negativisht në florëne faunën e tyre.

3.3 Ndikimet në ajër

Punimet kryesore për vendosien në funksionim të impiantit do të ejnë:

- *Sistemimi dhe mbushja e sheshit*
- *Hapja e kanaleve të menaxhimit të ujrave të shiut përgjatë pronës*
- *Instalimi i impiantit dhe ambjenteve të shërbimit*
- *Lidhja me sistemet e furnizimit me uji dhe energji elektrike*

Nga zbatimi i këtyre punimeve do të kemi emetim të gazeve të cilat vijnë nga djegia e karburantit nga automjetet e punës dhe shpërndarja e grimcave të ngurta, pluhrave nga qarkullimi i automjeteve.

Gjatë fazës së funksionimit të impiantit, nga zhvillimi i proceseve të trajtimit do të kemi emetim të gazeve si: SO₂, NO_x, CO, VOC, metalet e rënda dhe grimcat e ngurta PM_{2.5} dhe PM₁₀.

3.4 Ndikimet në ujrat sipërfaqësorë

Zhvillimi i projektit është një kontribues në reduktimin e mbetjeve hidrokarbure të cilat shkakrohen në trupat ujorë. Ujrat të cilat do të përftoheshin nga procesi i trajtimit priten të jenë ujra pa përmbajtje hidrokarbure. Para shkakrimit të tyre në mjedisin kompani të sigurohet që të realizohet monitorimi i cilësisë së tyre.

3.5 Zhurmat

Keto ndikimi janë ndikime që gjenerohen gjatë procesit të ndërtimit për të cilat subjekti do të marrë masë për reduktimin e tyre.

Nuk duhet të kalohen nivelet e zhurmave të përcaktuara në udhëzim nr.8, datë 27.11.2007 "për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3.6 Krijimi i mbetjeve

Mbetjet të cilat do të vijnë nga faza e ndërtimit dhe instalimit të impiantit do të jenë kryesisht mbetje të dherave (nga sistemimi i sheshit) dhe mbetje të tjera ndërtimi. Ato priten të jenë në sasi të vogël dhe lehtësisht të menaxhueshme.

Gjatë fazës së funksionimit të impiantit mbetjet që do të gjenerohen do të jenë nënprodukte të procesit të trajtimit. Ato do të jenë:

- Uji
- Dhera dhe rër
- Naft bruto
- Mbetje të tjera

Kompania do të sigurojë menaxhimin e tyre në destinacionet përkatëse.

3.7 Ndikimet pozitive të projektit

Përmirësimin e situatës mjedisore nga keqmenaxhimi i trashguar i mbetjeve hidrokarbure në ato vende ku do të merret kjo mbetje. Largimi i mbetjeve nga mjedise të hapura në të cilat aktualisht gjendet do të sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, përmirësim të cilësisë së tokës, të bimësisë, të peisazhit, përmirësim të jetës së banorëve.

- Sjellja e një teknologjia bashkohore për trajtimin e mbetjeve hidrokarbure duke mos lënë rrugë metodave primitive të trajtimit.
- Përmirësim i gjendjes së mjedisit në zonat industriale duke larguar mbetjet me naft në mjedis
- Përmirësim i cilësisë së ujërave të lumenjve
- Përmirësim i cilësisë së tokës
- Reduktim i burimeve të emetimit të substancave volatile VOC nga lënia e mbetjeve me hidrokarbure në mjedis të hapur.
- Rritja e përfitimeve ekonomike

4. Masat për shmangien apo reduktimin e ndikimit në fazë ndërtimi dhe funksionimi

Masat për shmangien apo reduktimin e ndikimit në fazë ndërtimi dhe funksionimi

Treguesi i ndikuar	Masat zbutëse
--------------------	---------------

Ndikimet në tokë	<ul style="list-style-type: none">- Të largohet menjëherë cdo shkarkim i pakontrolluar i karburanteve apo mbetjeve të naftës- I gjithë sheshi i objektit të shtrohet me beton ose çakull- Të mbahet pastër ambjenti i punës- Të mirmbahet gjendja mekanike e automjeteve dhe impiantit me qëllim shmangien e shkarkimeve të pakontrolluara në mjedis-Mbetjet të cilat meren nga subjektet e ndryshme të depozitohen më parë në kontenjer të izoluar e më pas të kalohen në impaint për trajtim-Të ndërtohet vaska e cila do të grumbullojë ujin që gjenerohet nga procesi i trajtimit.
Cilesia e ajrit Shkarkimi i gazeve (CO, NOX, CO2, SO2, CH4, H2S, THC,VOC) dhe grimcave të ngurta	<p>Përdorimi i kamionëve dhe automjeteve që emetojnë gaze nga djegia e karburantit brenda normave të lejuara (Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis gazet dhe zhurmat”)</p> <ul style="list-style-type: none">- Shmangia e mbetjeve të patrajtuara në mjedis të hapur për një kohë të gjatë, sidomos në periudhën e verës pasi, temperaturat e larta nxisin emetimin e substancave volatile- Kontrolli i vazhduar i gjendjes mekanike të impiantit për të shmangur rrjedhjet e pa kontrolluara- Monitorimi periodik i cilësisë së ajrit para se të shkarkohet në mjedis cilësia e ajrit të jetë brenda normave të përcaktuara në VKM Nr. 435, date 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në republikën e shqipërisë”- Ndërrimi i filtrave sipas udhëzimeve të katalogut të tyre të Prodhimit.
Vegjetacioni	<p>Për të shmangur dëmtimin e vegjetacionit përreth objektit kompania të ndalojë shkarkimet e pakontrolluara në mjedis</p> <ul style="list-style-type: none">- Të rrethojë objektin për të kufizuar aktivitetin vetëm në sipërfaqen e kërkuar
Cilësia e ujrave	<ul style="list-style-type: none">- Ujrat e shkarkimit të jenë brenda normave të përcaktuara në VKM nr. 177 datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse” shtojca 3 pika 8.1 “prodhimi I nënprodukteve te naftës”.

Zhurmat

Kompania të ndërpres punën gjatë natës, vetëm për proceset të cilat emetojnë zhurma

- Të servisohen automjetet të cilat emetojnë zhurma mbi atë normale
- Automjetet të fiken në kohën që nuk janë në përdorim

Të ndalohet rënia e borive, duke qënë se objekti ndodhet në qendër të banuar.

- Të kryhen monitorimet periodike të emetimit të zhurmave me qëllim vlerësimin e nivelit të tyre në raport me normat e lejuara të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8 datë 27.11.2007

“Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara”,

Komuniteti

Të punësohen persona nga zona e objektit

- Subjekti të zbatojë kushtet e vendosura në lejen mjedisore dhe në raportin e VNM-së.
- Kompania të marrë në konsideratë çdo shqetësim që mund të kenë banorët nga funksionimi i aktivitetit